



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Durrës  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROÇESVERBAL**

**Nr. 6, datë 31.03.2022**

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin Mars, që zhvillohet tek  
salla e Qendrës Kulturore “Aleksandër Moisiu”**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:02

Data e mbajtjes së mbledhjes : 31.03.2022

Mbajtja e mbledhjes : salla e Qendrës Kulturore “ Aleksandër Moisiu”

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

**Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës** : Znj.Emiriana Sako dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

**Ani Dyrmishi** : Të nderuar Këshilltarë ! Të nderuar pjesmarrës ! Të nderuara media!  
Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës për muajin mars të Këshillit Bashkiak Durrës.  
Ftoj Sekretaren e Këshillit të bëj prezencën .

**Dorina Milja:** Faleminderit Kryetar!

Fillojmë me prezencën. Jolanda Mustafaraj ... prezent.....etj ..... Morena Boja.....prezent.  
Kryetar ke 38 këshilltarë në sallë. (*ndërkohë me vonesë te pika 6 e rendit të ditës ka hyrë dhe është ulur në sallë dhe Fatmir Mërkuri*), pra 39 këshilltarë.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit. Atëherë meqenëse kuorumi është i pranishëm vazhdojmë me mbledhjen.

Përpara se të kalojmë në rendin e ditës do të bëjmë shpalljen e vlefshmërisë së mandatit të kryetares së bashkisë si dhe betimi para këshillit.

Me vendim nr.95 , datë 18.03.2022 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës në mbështetje të nenit 60 të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ka vërtetuar mandatin e kryetarit të bashkisë.

Ftoj znj. Emiriana Sako të ngrihet në këmbë.

Unë do të lexoj formulën e betimit, Ju do të thoni betohem.

*“Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e Kryetares së Bashkisë dhe do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të bashkisë Durrës dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.*

**Emiriana Sako** : Betohem !

**Ani Dyrmishi** : Ftoj Sekretaren t’i paraqesë për nënshkrim Kryetares së Bashkisë “Formulën e betimit”.

*(.....Kryetarja e Bashkisë firmos formulën e betimit. Kryetari i Këshillit i vendos shiritin kuq e zi Kryetares së Bashkisë dhe uron “Suksese”. Duartrokitje nga këshilltarët, nga te ftuarit dhe të pranishmit në sallë.....).*

**Ani Dyrmishi** : Ftoj Kryetaren e Bashkisë të mbaj fjalën përshëndetëse.

**Emiriana Sako** : Falenderoj përzemërsisht të gjithë qytetarët e Durrësit që me datë 6 mars besuan tek unë. Për mua është një privilegj i jashtëzakonshëm dhe një përgjegjësi e madhe për drejtimin e Bashkisë së dytë në Shqipëri. Gjithashtu kam angazhimin që t’i shkoj në fund të gjitha premtimeve apo detyrave për të cilat jam angazhuar përballë qytetarëve të Durrësit dhe në një farë mënyre jam dhe krenare që do të jemi të gjithë së bashku pjesë e transformimit të qytetit dhe ndryshime që do të pësoj qyteti i Durrësit falë edhe vizionit të kryeministrit Edi Rama.

Në prioritetin tim do të mbetet programi i rindërtimit, pasi dhe këto dy vite puna jonë ka qënë e fokusuar në këtë projekt.

Unë dua të falenderoj kryesinë e Partisë Socialiste, dua të falenderoj të gjithë anëtarët e këshillit bashkiak, të cilët kanë bërë një punë të jashtëzakonshme këto dy vite që kanë mbështetur bashkinë e Durrësit dhe mua në drejtimin e saj. Gjithashtu dua të falenderoj të gjithë ata këshilltarë që kanë qënë pjesë e fushatës time dhe kanë mbështetur kandidimin tim. Faleminderit të gjithëve.

*(.....duartrokitje .....*

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit Kryetare dhe nje herë urime dhe suksese detyrën tuaj.

Kalojmë në rendin e ditës po vazhdoj me leximin e pikave që na shtrohen sot për rend dite.

1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6 % DHE FONDI NGA TË ARDHURAT E BASHKISË, PËR MUAJIN MARS 2022
--	---

2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB NR.15, DATË 22.02.2021, VKB NR.50, DATË 14.04.2021, VKB NR.55, DATË 26.06.2020, VKB NR.64, DATË 07.07.2020, VKB NR.67, DATË 14.07.2020, VKB NR.71, DATË 20.07.2020, VKB NR.78, DATË 10.08.2020, VKB NR.81, DATË 10.08.2020, VKB NR.115, DATË 30.09.2020, PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË GRANTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN OSE RIPARIMIN E BANESAVE TË DËMTUARA SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË DËMIT
3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR NGRITJEN E SHËRBIMEVE ME BAZË KOMUNITARE PRANË QENDRËS KOMUNITARE MULTIFUNKSIONALE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE RRASHBULL, DURRËS
4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË ANEKSIT NR. 2, 4, 5, TË VKB-SË NR.74, DATË 24.07.2020 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 1, 3, 4, 6, SUKTH DHE ISHËM, BASHKIA DURRËS” PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË GRANTIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT E DËMTUARA SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË DËMIT
5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E RAPORTIT MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2021
6. Shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE TË TRASHËGUARA NGA VITI 2021, TË CILAT I SHTOHEN BUXHETIT TË VITIT 2022 TË BASHKISË DURRËS
Pyetje dhe diskutime nga këshilltarët	DISKUTIME DHE PYETJE

Atëherë ka ndonjë koment përsa i përket rendit të ditës ?

Atëherë nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës? Kundra?.... Apstenim ? ..... Nuk ka.

Atëherë me 38 vota pro miratohet rendi ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit të **pikës 1** , i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjimore dhe Mirëqënies Sociale, znj. Klementina Meçi.

**Klementina Meçi:** Faleminderit Kryetar! Mirëdita të gjithëve!

Përfitoj nga rasti që t'i uroj znj.Sako punë të mbarë në vijim dhe suksese.

Në lidhje me relatimin e pikës së parë të rendit të ditës Komisioni Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale mori në shqyrtim nëpërmjet komunikimeve elektronike pikën e parë të rendit të ditës dhe vendosi miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë për 90 familje dhe miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi 6% i fondit kushtëzuar për 23 familje.

Nga sa më sipër komisioni vendosi me vota unanime kalimin e projektvendimit për votim në mbledhjen e ditës së sotme. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit znj. Meçi.

Përsa i përket pikës 1, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës? Kundra?.... Apstenim ? .....Nuk ka.

*Atëherë miratohet me 38 vota pro pika 1 e rendit ditës.*

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 2 të R.D.**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike me kryetare znj. Alneida Rroshi.

**Alneida Rroshi :** Faleminderit Kryetar!

Unë gjithashtu dua të uroj Kryetaren e Bashkisë për t'i thënë shumë urime e shumë suksese.

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike përsa i përket miratimit të ndryshimit të VKB nr.15, VKB nr.50, VKB nr.55, VKB nr.64, VKB nr.67, VKB nr.71, VKB nr.78, VKB nr.81, VKB nr.115, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar pikën 2. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit znj. Rroshi.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike me kryetar z. Elio Jani.

**Elio Jani :** Faleminderit Kryetar!

Edhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e bashkisë dhe propozon miratimin e saj. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit z. Jani.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës kryetare znj. Etleva Velçani.

**Etleva Velçani :** Faleminderit Kryetar !

Meqenëse dhe mua mu dha fjala doja t'i uroja dhe Kryetares suksese gjithashtu dhe nga grupi i pavarur suksese për mandatin.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi të gjithë relacionin votoi me shumicë votash kalimin në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit znj.Velçani.

Përsa i përket pikës 2 kemi komente nga ana e këshilltarëve ? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës? Kundra?.... Apstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë miratohet me 38 vota pro dhe pika 2 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e pikës **3 të rendit të ditës** i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale, znj. Klementina Meçi.

**Klementina Meçi:** Komisioni Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale mori në shqyrtim dhe pikën e tretë dhe vendosi :

Miratimin e ngritjes së shërbimeve me bazë komunitare pranë Qendrës Komunitare Multifunkionale në Njësinë Administrative Rrashbull, Durrës.

Miratimin e përdorimit të fondit prej 1.350.504 lekë të miratuar me VKB-në nr.158, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës” për drejtuesin e qendrës dhe punonjës social i cili do të kryejë funksionet e Njësisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave për Njësinë Administrative Rrashbull.

Nga sa më sipër komisioni vendosi në mënyrë unanime kalimin për votim në mbledhjen e ditës së sotme. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Komisioni i Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave me Kryetare znj.Pamela Bardhaj.

**Pamela Bardhaj :** Faleminderit.

Urimet më të mira për mandatin Kryetares së Bashkisë.

Edhe Komisioni i Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave vendosi pro miratimit të kësaj pike të rendit të ditës. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit .

Komente përsa i përket pikës 3 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës? Kundra?.... Apstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 38 vota pro miratohet dhe pika 3 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 4 të R.D**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

**Alneida Rroshi :** Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike pasi mori në shqyrtim pikën 4 të R.D, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Jani.

**Elio Jani :** Faleminderit Kryetar.

Edhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e bashkisë dhe propozon miratimin e pikës 4. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani** : Edhe Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi të gjithë relacionin vendosi për kalimin në votim të pikës 4 të R.D. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Atëherë komente përsa i përket pikës 4 kemi nga ana e këshilltarëve ? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës? Kundra?.... Apstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë miratohet me 38 vota pro dhe pika 4 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e pikës **5 të rendit të ditës** i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave me Kryetare znj.Pamela Bardhaj.

**Pamela Bardhaj** : Edhe për këtë pikë komisioni ynë vendosi me të gjitha votat pro mbi miratimin e “Raportit mbi monitorimin e zbatimit të buxhetit të bashkisë Durrës për vitin 2021”

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit .

Përsa i përket pikës 5 të rendit të ditës, kemi komente nga ana e këshilltarëve? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës? Kundra?.... Apstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 38 vota pro miratohet dhe pika 5 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit të pikës **6 të rendit të ditës**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj. Bardhaj.

**Pamela Bardhaj** : Komisioni ynë vendosi pro miratimit të kësaj pike të rendit të ditës.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj.Bardhaj.

Përsa i përket pikës 6 të rendit të ditës, kemi komente nga ana e këshilltarëve? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 6 të rendit të ditës? Kundra?.... Apstenim ? .....Nuk ka.

**Dorina Milja** : Kryetar ke 39 këshilltarë në sallë.

**Ani Dyrmishi** : Me 39 vota pro miratohet dhe pika 6 e rendit ditës.

Kështu përfunduar të gjitha pikat që kishim për tu shqyrtuar në rendin e ditës.

Nga ana këshilltarëve ka kërkuar fjalën për diskutim znj.Velçani.

**Etleva Velçani** : Faleminderit Kryetar !

Duke qënë se është një çështje që është diskutuar disa herë , do t'i lutesha Kryetares nëse mundet që banorëve të pallatit nr.15 t'i kthejnë një përgjigje zyrtare. Vetëm këtë doja, sepse banorët duke të falenderuar pa masë për të gjitha komunikimet verbale që ne kemi bërë, bashkë dhe me pritjen që i keni bërë dje banorëve. Por ato duan një përgjigje zyrtare ku ta kenë si bazë ku të mbështeten, qoftë dhe në kundërshtim, por që të jenë të parashtruara të gjitha pikat përse kundërshtohet kjo kërkesë të cilën ata e kanë paraqitur .

**Emiriana Sako :** Në rregull, patjetër “Ne” siç e përmenda dhe pak më parë e kemi prioritet programin e rindërtimit. Objekti i ish firmës “Gora” është një objekt që ka një situatë komplekse për nga ana teknike. Ne kemi qenë në bashkëbisedim të vazhdueshëm për këtë godinë, pikërisht për të qenë tërësisht të sigurt tek vendimmarrja para se ta përcjellim në këshill bashkiak. Ka pasur diskutime teknike nga ana e Institutit dhe e Bashkisë për sa i takon vendimmarrjes për qëndrueshmërinë e tij. Dhe kjo nuk është vonesë, por është një kohë e nevojshme për të dhënë sigurimë maksimale për jetët e njerëzve. Kështu që patjetër do të kthejmë një përgjigje me shkrim, por thelbi i gjithë diskutimit nuk është kthimi i përgjigjes me shkrim apo jo, sepse “Ne” jemi duke u marrë në mënyrë të vazhdueshme me këtë objekt në mënyrë që të kemi mundësi që sigurojmë qëndrueshmërinë e tij. Pra nëse objekti është i qëndrueshëm do të qëndroj siç është dhe do të kaloj në program riorizimi, nëse do të marrë një përgjigje përfundimtare nga Instituti që objekti duhet shëmbur, pastaj qytetarët kanë të drejtë të ankohen në institucionet përkatëse për vendimmarrjen që do marrim, por “Ne” do t’i qëndrojmë aktin normativ nr.9 dhe kompetencave që na jep ky akt.

**Etleva Velçani :** Ideja është vetëm se këto nuk janë dakort me oponentin që është dhënë. Pra projekti që është dhënë nuk janë dakort banorët pasi pikat që janë shtruar aty, të paktën 3 pika njëherë janë jashtë ç’ka është në të vërtetë. Ky është kundërshtimi më i madh që banorët po i tensionon kaq shumë, vetëm për këtë kërkojnë rishikim të projektit, prapëse vënë të rishikohet të ngrihet një grup i posaçëm që të vërtetojë nëse kjo oponenti, që me të drejtën e vet banorët e kundërshtojnë, është e saktë apo jo. Dhe pastaj dhe ato binden, ok. Nëse oponenti e tretë thotë ky pallat nuk qëndron, nuk është për rikonstruksion dhe ok është në rregull. Por banorët dyshojnë tek kjo oponenti , ndoshta dhe unë një fakt e kam marrë për të qenë më saktë. Oponenti që mbahet nga Instituti, normalisht një shkresë zyrtare që del nga institute minimum duhet të ketë 4 firma. Oponenti që ka ardh për këtë pallat, drejtoresha vet punon, vet firmos . Më fal ku janë 2 inxhinjerët që janë minimalisht një shkresë zyrtare ka 4 firma, prandaj i kam parë me detaje të gjithë problemin. Vetëm ky është gjithë problemi i këtyre banorëve që shqetësohen kaq shumë me këtë projekt.

**Emiriana Sako :** Këshilli bashkiak nuk mund t’i futet analizës se kush firmos në dokumentat e një institucioni tjetër, pra “Ne” kemi kompetencat tona. Ka pasur dhe herë të tjera që banorët kanë kundërshtuar shembjen e objektit, por kundërshtimi nga ana banorëve nuk bën ndryshim të vendimit. Pikërisht për pikat që ju përmendët “Ne” po flasim me Institutin që të shikohen ose rishikohen me kujdes, apo të argumentohen këto vendimmarrje lidhur me këto 3 pika dhe kjo është koha e nevojshme që ka dashur ky proces. Pastaj ka firmosur specialisti Institutit apo jo, kjo është një çështje, që mendoj se është jashtë kësaj sale.

**Etleva Velçani :** Jo unë e kisha në lidhje me llojin e oponentit që ka ardh, pra ka shumë fakte dhe kjo ishte një ndër faktet që banorët kundërshtojnë, që të jem më e qartë. Por faleminderit gjithsesi dhe për sqarimin. Duhet të kuptonin se dhe unë jam nën ndikimin e banorëve nëse ata kërkojnë diçka unë jam e detyruar ta paraqesë në këshill.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit znj. Velçani.

Nëse Kryetarja ka diçka tjetër për të shtuar.

**Emiriana Sako** : Jo, faleminderit. Faleminderit të gjithëve.

**Ani Dyrmishi** : Atëherë, Ju falenderoj të gjithëve për pjesmarrjen, përfaqësuesit e bashkisë, subjektet politike, Prefektin në veçanti dhe gjithë pjesmarrësit e tjerë mediat .  
Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

*Ky procesvebal mbyllet me nr.rendor 8(tetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset sipas Rregullores së Funkcionimit të KB nga Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit.*

**Mbajtësi i proçesverbalit:** Dorina Milja

**Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :**

Kryetari Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretare e Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetari Grupit të Partisë Socialiste të KB :

ELIO JANI

Kryetare Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI